

## Lojëra për stimulimin e të folurit

### Mosha 6-12 muaj

**Prekni objekte të ndryshme me fëmijën.** Gjeneroni objekte të thjeshta në shtëpinë tuaj si p.sh. arush, lule, gotë etj. dhe përshkruani cilësitë dhe ndjesitë e objekteve.

**Dëgjoni tinguj.** Mbajeni foshnjën në krahë dhe gjeneroni gjëra në ambientin e shtëpisë apo jashtë saj. Lëshojini objektet dhe përshkruani tingujt që bëjnë objektet. P.sh. i lartë, i butë etj.

**Ma-ma, ba-ba.** Prindërit vendosin fëmijët në mes. P.sh. Kur ai thotë “ma”, nëna e mer në prehër, e përqafton duke i thënë: “Oh, ti the mami”. Kur thotë “Ba”, babai e mer në prehër, e përqafton dhe i thotë “Bravo, ti the babi!”

### Mosha 12-18 muaj

**Loja me kukulla.** Vizatoni një kukull me fytyrë të mërzhitur dhe një me fytyrë të lumtur. Tregoni dhe shpjegoni emocionet. Më pas, jepni shembuj se pse është e mërzhitur apo e lumtur kukulla, duke e lidhur me një aktivitet.

**Emërtoni pjesët e trupit.** Qëndroni në këmbë dhe përballë me fëmijën tuaj. Vendosni gishtin në pjesët e trupit tuaj, duke i emërtuar ato dhe inkurajojeni fëmijën të bëjë të njëjtën gjë.

Lëreni fëmijën të krijojë një çantë me lodrat e tij të preferuara. Më pas kërkojini t’i nxjerrë nga çanta duke i emërtuar.

“Bëj si bëj unë, bëj si them unë!” Luani para pasqyrës me fëmijën duke bërë shprehje të ndryshme të fytyrës. Lëvizni pjesë të ndryshme të trupit duke emërtuar veprimin. Përsërisni fjalët që thotë fëmija.

**Luani duke ndërtuar me kuba.** Luani me kuba duke përshkruar ngjyrat.

### Mosha 18-24 muaj

**Prisni figura të ndryshme nga librat dhe revistat, duke ndërtuar disa kategori si:** kafshë, lodra, ushqime. Uluni me fëmijën tuaj dhe emërtojini këto objekte, duke i kërkuar atij t’i vendosë në kategorinë përkatëse.

**Albumi i fotografive.** Shikoni bashkë me fëmijën foto të familjes dhe përshkruani njerëzit, veshjet e tyre, vendet, etj.

### Mosha 24-36 muaj

**Pyeteni fëmijën vazhdimisht për objekte.** Ndërkohë që lëvizni bashkë me fëmijën në shtëpi apo mjedise të ndryshme, pyeteni atë rreth objekteve: për ngjyrat, tingujt që bëjnë, a i pëlqejnë, etj.

**Lejojini fëmijës të kërkojë objektet që dëshiron.** Vendosni 3 gjëra dhe thuajini fëmijës të kërkojë njëren prej tyre në këtë formë: “Unë dua makinën. Po ti çfarë?”



**o më e vogël.** Gjeneroni objekte çift, si: lugë, makina, kuba etj. mijës t’i rendisë sipas madhësisë së objekteve nga ato të



**Bashkia Tiranë  
Qendra Ekonomike e  
Zhvillimit dhe Edukimit të  
Fëmijëve**



### Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve 0-3 vjeç



**Adresa: Rruga e  
Barrkadave.  
Tel. 042222991  
Website: femijet.al**

## Zhvillimi i gjuhës në 3 vitet e para



Strukturat themelore të gjuhës krijohen 3 vitet e para të jetës. Referuar studimeve, më poshtë janë paraqitur hapat normativë të zhvillimit gjuhësor në 3 vitet e para.

**1-6 muaj:** Foshnja bën guga në përgjigje të zërit që i flet.

**6-9 muaj:** Foshnja belbëzon.

**10-12 muaj:** Imiton tinguj. Thotë “mama/ baba” pa kuptim.

**12 muaj:** Thotë “mama/ baba” me kuptim. Zakonisht imiton fjalët 2-3 rrokëshe.

**13-15 muaj:** flet deri në 4-7 fjalë. Më pak se 20% e të folurit të tij kuptohet nga pesona të tjerë.

**16-18 muaj:** flet deri në 10 fjalë. Përdor zhargonin e tij dhe imitimn e fjalëve. 20-25% e të folurit kuptohet nga pesona të tjerë.

**19-21 muaj:** Ka fjalor deri në 20 fjalë. 50% e të folurit kuptohet nga pesona të tjerë.

**Mosha 24-30 muaj:** Ka një fjalor me 400 fjalë, duke përfshirë emrat, fjalitë me 2-3 fjalë, përemrat. 75% e të folurit kuptohet nga pesona të tjerë.

**Mosha 30-36 muaj:** Përdor shumësin dhe kohën e shkuar, numëron 3 objekte me saktësi, përdor fjali 3-5 fjalëshe. 80-90% e të folurit kuptohet nga personat e panjohur.

**Mosha 3-4 vjeç:** Krijon fjali me 3-6 fjalë, bën pyetje, bashkëbisedon, tregon histori. Pothuajse i gjithë i foluri i tij është i kuptueshëm nga personat e tjerë.

**Kujde të mëdha se nëpërkons**



**vidual shoni nuk ë shës.**

## Teknika për stimulimin e të folurit

**Flisni ngadalë!** Përpiquni të flisni ngadalë dhe duke i shqiptuar të plota fjalët.

**Flisni me fëmijën për atë që po bëni!** P.sh. “Tani po hedh qumështin në gotë”.

**Përsërkroni atë që fëmija është duke bërë!** P.sh. “Ah, ti po buzëqesh”.



**Shprehni fjalës që thotë fëmija!** P.sh. “Ah, ti kërkon top” thuajini “Ah, ti kërkon

nitoni belbëzimet shprehjet e stet që bën fëmija. Kthejini përgjigje fëmijës edhe për belbëzimet që bën.

**Dialogoni me fëmijën tuaj!** Kur fëmija juaj merr një përgjigje pozitive nga ju, atëherë ai praktikohet më mirë për të folur.

**Mos i korrighoni gabimet e fëmijës në artikulum!** Korrighimi i fjalëve mund të kërkojë energji dyfishe nga ana e fëmijës dhe i jep atij një mesazh negativ.

**Lexojini fëmijës suaj çdo ditë!** Fëmijët mësojnë shumë nga historitë, dëgjojnë rimën, fjalën e saktë dhe tregojnë vëmendje ndaj figurave.